VENDIM
Nr.456, datë 5.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.661, DATË 25.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSITAR TË ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJISË NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe nenit 16 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.661, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shtesa:
a) Në pikën 5, fjalët "...brenda vitit 2005..." zëvendësohen me "...brenda vitit 2009…".
b) Pas pikës 6 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
"Për përballimin e shpenzimeve të tjera operative, për funksionimin e shërbimit të ortopedi-traumatologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë, nga buxheti i vitit 2006, zëri "Shpenzime për mallra e shërbime", t'i zbritet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, i cili të shtohet në buxhetin e vitit 2006, zëri" Shpenzime për mallra e shërbime", miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes. Për vitet e tjera, deri në transferimin e këtij shërbimi nga mjediset e SUQU-së, në buxhetin e çdo viti, që do të miratohet për Ministrinë e Mbrojtjes, zëri "Shpenzime për mallra e shërbime", të parashikohet fondi i nevojshëm për përballimin e shpenzimeve të tjera, për funksionimin e shërbimit të ortopedi-traumatologjisë, përveç parashikimeve për medikamente e materiale mjekimi, të cilat do të parashikohen dhe do të përballohen nga buxheti, që do të miratohet, çdo vit, për Ministrinë e Shëndetësisë.".
2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha